

Rezultatet e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED (të përkohshëm)

Sot, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, Z.Gramoz Ruçi, në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d të Kushtetutës, nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Urdhrit nr. 2, datë 3.12.2018, të Kryetarit të Kuvendit “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, në ambientet e Kryesisë së Kuvendit, salla “Pjetër Arbënor”, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm)

Në përfundim të hedhjes së shortit, Kryetari i Kuvendit Z.Gramoz Ruçi, shpalli emrat e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm), të përzgjedhur nga shorti, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues, si vijon:

Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:

- | | | |
|----|------------------|---|
| 1. | Vitore Tusha | Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese |
| 2. | Bashkim Dedja | Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese |
| 3. | Ardian Dvorani | Gjyqtar i Gjykatës së Lartë |
| 4. | Arta Marku | Prokurore nga Prokuroria e Përgjithshme |
| 5. | Fatri Islamaj | Gjyqtar nga gjykatat e apelit |
| 6. | Margarita Buhali | Gjyqtare nga gjykatat e apelit |
| 7. | Fatjona Memçaj | Prokurore pranë gjykatave të apelit |
| 8. | Eriol Roshi | Gjyqtar nga gjykatat administrative |

Anëtarë zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

- | | | |
|----|-----------------------|--------------------------------------|
| 1. | Medi Bici | Gjyqtar i Gjykatës së Lartë |
| 2. | Gurali Brahimllari | Gjyqtar nga gjykatat e apelit |
| 3. | Klodiana Veizi (Mema) | Gjyqtare nga gjykatat administrative |